

Rrëshen, më 20.10.2023

DETYRA MËSIMORE E M2-shit, C 9

MËSUESE: Elsa GJETA

FUSHA: Gjuhët dhe komunikimi

LËNDA: Gjuhë shqipe

SHKALLA: VI

KLASA: 12 C

TEMATIKA: Llojet e teksteve

TEMA: Intervista për punë, Letra e mospranimit, Ankesa, Ftesa

SITUATA E TË NXËNIT: Nxënësit lexojnë në klasë lloje të ndryshme intervistash, letra mospranimi, ankesa dhe ftesa.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇ:

1-Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

2-Të folurit për të komunikuar dhe mësuar

3-Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS SIPAS TEMËS MËSIMORE

- Të mësuarit për katër tema , që mund të ndahen në pjesë të veçanta
- Rritja/përmirësimi i aftësive bashkëpunuese
- T'u jepet nxënësve përgjegjësi për të mësuarit e tyre
- Praktikimi i gjetjes së pikave kryesore në materialin studimor

MATERIALET: Teksti i nxënësit, flit charp, kolora, fletore, fletë studimi me pyetje për t'i ndihmuar nxënësit të gjejnë pikat kryesore të materialit, fletë me ngjyra..

ZHVILLIMI I MËSIMIT

Prezantimi metodës: Njihen nxënësit me mënyrën se si do të punohet përgjatë kësaj ore mësimore.

Si fillim perdora metodën 1-2-3

AKTIVIZIMI I NZËNËSVE

Disa nxënës lexuan me zë modele tekstesh të ndryshme.

“PUZZLE” NË BASHKËPUNIM

Klasa ndahet në kater grupe. (klasa është e 12 C , gjithsej 20 nxënës)

Katër temat që do tajtoheshin ishin shkruar në katër fletë A4

Një përfaqësues grupi bën zgjedhjen dhe pastaj punon në grup.

Zgjidhet një zot shtëpie , të tjerët lëvizin nëpër stacione,ku marrin informacionin e ri ose bëjnë pyetje.

Diferencimi: Të gjithë nxënësit marrin ushtrimet e ndryshme në fletë me ngjyra të ndryshme dhe i zgjidhin në fletoren e tyre.(i gjithë procesi është sqaruar,fletët jeshile pyetje të lehta për tu zgjidhur,të verdhat nivel mesatar,të kuqet të vështira,ata mund të zgjidhin pyetjen dhe e kthejn dhe marrin tjetër..)









